

85H-1

K 95

MAKSIM KROI

Kur nisim  
vargjet...

POEZI

891.983-1  
K 95

S

MAKSIM KROI

# KUR NISIM VARGJET...

( vjersha )

~~SKSF8~~  
13135  
~~JIEM~~ 

新編增補古今圖書集成

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970

## MENDIMI I TIJ

Mendimi i tij  
Është zjarr i pashuar,  
Që hirin lë nga bota e vjetër  
Dhe lind pér ne ditët e bardha,  
Horizontet e ndritura që na hapen pérpara...

Mendimi i tij  
Është ëndrra e jonë,  
Sirenë e fuqishme e ditëve komuniste,  
Është shpatë e mprehtë, armiqtë i shkatërron  
Diell i artë, i kuq që botën gjithë ndriçon...

Mendimi i tij  
Është kazmë e pushkë,  
Forca e klasës, shkatërrimi i zakonit,  
Busull që rrugën tregon në çdo kohë,  
Gjaku i pastër në dejet e shqiptarit...

Mendimi i tij  
Na bën tē pavdekshëm,  
Fitimtarë na nxjerr nē çdo betejë,  
Se Atdheu anembanë është i lidhur  
Me nyje tē çelikta, parti-popull-Enver. . .

1968.

**8 NENTORI 1971**

Atë natë Partia do të festojë 30-vjetorin.  
Shqipëria do më ngjajë si një qiełl,  
Ku do të ndizen me mijëra e me mijëra  
Fishekzarë-drita...

Në trup të saj llambat elektrike  
Do hedhin vallen e madhe të elektrifikimit.  
Në trup të saj do shtrihen linjat  
Si fijet e pambukut në një maqinë tezgjahu  
Në kombinatin e tekstilit...

Shqipëria do më ngjajë si një qiełl,  
Ku do të ndizen me mijëra ëndrra,  
Me mijëra shpresa e dëshira.  
Dhe në atë natë mes drithash pambarim  
Do festojë jubileun

Partia...

Errësira e mundur do shkojë jashtë kufive.  
Në shtëpi të fshatarit, në rrugë e kudo,  
E zënë dorë më dorë me kabllo tensioni  
Shqipëria e tërë do qeshë e gëzojë.

Është afër ajo ditë. Po vjen. Nxiton...  
Atdheu do shkëlqejë më shumë se tani  
Në qellin e përflakur të revolucionit,  
Fishekzarët — drita do shkruajnë

Parti!...

1968

## RREZET RENDËN...

Partia nisi kudo një Letër\*)

Nëpër Shqipëri...

Autobuseve, postjerët pasagjerëve u tregojnë  
gazetën,

Lajmin e ri...

Si një mendim i qartë ajo zbriti në popull,

Këmbékryq u ul nëpër vatra,

Me ne të bisedojë.

E ngrohtë, oh sa e ngrohtë!

E aq shumë, aq shumë na mësoi!

E rrëmbyen bjeshkët

Dhe e ngjitën varg, mal më mal  
tutje, larg...

Nëpër gurra të pastra,

---

\*) Letra e hapur Mars 1970.

Midis linjave të elektrifikimit  
Shkoi ajo, optimiste në rrugën e Shqipërisë  
së re.  
Si diell i artë hodhi rrezet mbi ndërgjegjen  
socialiste...

## ME NATËN

Me natën e lanë atë shokët,  
Ndërsa shkuan të pushojnë,  
Shkroi vargje gjithë natën  
Nën dritën e fortë të llambës.

Dhe fjeti ashtu i mbështetur te shtylla.  
Temperatura ulej dalëngadalë.  
I çuditshëm është kujdesi i shokëve:  
Kur u ngrit ishte në krevat...

Të gjithë shumë e duan  
Poetin vullnetar që thur vargje,  
Atë që për vendin e dashur  
Penën barot e ka gati...

*Qershori 1968*

## **DASHURIA**

**D. B.**

Dashuria nuk është si valët e lumit që shkasin,  
shkasin tutje...

Ajo përjetë ka zënë vend në zemrat tonë të reja,  
Ndaj gëzohemi dhe na qeshet fytyra,  
Tek hedhim hapat drejt shtigjeve të ardhme...  
Dashuria nuk mundet të harrohet, si një gur në  
mes të zallit

E të humbasë...

Ajo rron në çdo qelizë e gjallë, e shëndetshme,  
Të dy na shtyn përpara, përpara...  
Në këto ditë optimiste...

*Nëntor 1968*

## TAKIM ME BABANË E DËSHMORIT MARK RRËZA

Vitet lanë mbi të shumë, shumë kujtime,  
Por mbi të gjitha ngrihet kujtimi për djalin e  
rënë...

Shkoi larg ati t'i mbledhë kockat birit  
Maleve të lartë hijerëndë...

E kërkoi kudo, në lugje e shpate,  
Pyeti njerëz...

Qe i bindur ati se biri partizan  
Flinte këtu në malet zemërgjerë...

Eh, këto eshtra nuk e lodhën plakun  
Të endej kudo nga jugu në veri...

Mbi eshtrat në fshatin buzë detit kaltërosh  
Zbardhin lapidarın zambakët në agim...

*Shkurt 1969*

## TANI U BËMË BURRA

(Mësueses së parë Th. Cico)

Zogjtë e kujtimeve vijnë shpesh këtej nga unë,  
Sjellin me vete vitet e fëminisë.  
Tani u bëmë burra e,  
Diku çukasim me penë mbi mbresat e jetës. .  
Dikur të ulur në bangë,  
Me penën që dridhej në duar  
Shkruanim ato pak fjalë. . .

Ti kuvendoje me ne si nënë e mirë.  
Sa më pëlqen të dëgjoj prapë kur flet,  
Qortimet, fjalët e urta,  
Tregimet për partizanët, luftën  
Për jetën e re që pushtoi Atdheun. . .

Por, tani jemi burra,  
E u shpërndamë anembanë të derdhim djersën,  
Ashtu si na mësoje ti.  
Në kokë na rreh pulsi i kujtimeve të bukura,  
Ndaj çukasim me penë mbi mbresat e jetës. . .

*Mars 1969*

## E KUQE, E KUQE...

D. B.

Atëhere ish prill...

Nën rrpat, nën diellin që djeg

U njoha me të, me vajzën e shtrenjtë.

Pranverë...

Dhe si era që mbush rrugët ngarkuar me  
luleblirë,

Ma mbushi gjaku i dashurisë

Të kuqen zemër...

Koha do të lerë mbi tokë shumë ditë të tjera,

Do të blerojnë fushat,

Do të zverdhet gruri,

Po si një lule në mes fushash pa fund

Dashuria do të mbesë.

E kuqe, e kuqe...

*Prill 1969.*

## NË VLORË .

Poshtë në këmbë kam Vlorën dhe detin.  
Pse ky vend u quajt Kuzbaba?  
Mos ndoshta dikur një teqe do kish mbirë  
Në këtë park të bukur këtu lart...

Atëherë nga teqeja plot tym edhe blozë  
Njeriu i zotit sodiste përreth,  
Me fjalë të errëta si teqja e vjetër  
Mbështetur në shpatullat e besimit të vet...

Qëndroj i shtrirë në parkun e heshtur,  
Në det valëzat rrahin valëzat deri në thellësi.  
Sazani mbulohet me një tis mjegulle,  
Gjiu u mbështuall me rreze drite.  
Dielli horizontit i ra si me thikë...

Mbi brigjet vritten dallgët si parku vraud teqen.  
Deti shkumbëzon,  
Era sjell me vete tymin e oxhaqeve.  
Shoh vetëm blerim  
E ndjej një fllad pranveror...

Poshtë në këmbë kam qytetin,  
Pse ky vend u quajt Kuzbaba?  
Më mirë ta quaj dylbi e poetit,  
Me të shoh Vlorën, detin, shtëpitë, njerëzit.

*Prill 1969*

## V R E L L A . . .<sup>1)</sup>

Vrella nxirrte ujë që nga nëntoka,  
Uji i rrëmbyeshëm tretej në Valbonë,  
Në mulli të fshatit rrotullohej mokrra,  
Të dy me rapsodin pinim ujë të ftohtë.

Vrella është e bukur, e kristaltë, e tejdukshme.  
Gurët duken poshtë si yje të qartë;  
Vrella e Shoshanit, vrella mjekërgjatë  
Seç m'i ngau ndjenjat,  
Seç më lidhi vargun . . .

Qëndronim atje bashkë me rapsodin.  
Legjenda e saj vinte që nga kohët,  
Si ujë i kulluar që vjen nga nëntoka  
Tok me brirët, furkën dhe këmborën . . .<sup>2)</sup>

---

1) Vrella — burimi, gurra.

2) Ka të bëjë me legjendën e vrellës së Shoshanit.

E tregoi rapsodi legjendën e lashtë.  
Vrella buronte e pastër që nga thellësitë,  
Në mulli të fshatit bluhej misër i ri,  
Bluaja ca vargje...  
Ai rapsodi...

*Maj 1969*

## KOMISARËT...

Kush janë ata që vijnë nga maja e malit  
Me pushkë në shpatull dhe me krahë shqiponje?  
Gjaku i freskët u mbuloka ballin,  
Porsi në pranverë lulet mbushin tokën.

Vijnë që andej me këngë si vullkane,  
Njëshkollonë zbresin nga malet në rrugë.  
Kush janë, ku shkojnë me yje në krahë,  
Si sgalemet në mes detit me furtunë?

Filli i mendimeve i ndjek e i ndjek...  
I gjatë e i gjatë si brezi i fishekëve.  
O shokë komisarë, që rendni tek ne  
Të gjallë, stuhi, tamam si atëhere!

Uleni me ne në sofra dhe mbledhje,  
Na flisni për jetën e ndritur si dikur,

Komisarët tanë, të flaktë, të kuq,  
Me yje të zjarrtë edhe me një pushkë.

Eshtrat edhe gjaku gjenden nën tokë,  
Lapidarët ngrihen rëndë sipër saj,  
Fasha e gjatë e plagëve trupit u zbardhon,  
Shokë komisarë, trima partizanë...

S'kërkojnë qetësi në gjumin e gjatë,  
Komisarët tanë të fortë, kreshnikë  
Vijnë që nga fronti në ditët e majit,  
Pranë frontit duan gjithnjë që të rrinë...

*Maj 1969*

## K U D O

Ngado që vete në atdheun tim  
Partinë e Punës e gjej  
                          në zemrat e bashkatdhetarëve,  
Nëpër fasadat e uzinave,  
Ugareve në tokat e reja,  
Mbi shtyllat e hekurta të elektrifikimit,  
Pranë piramidave në kufi...  
Në këtë tokë heroike, si nëpër faqet e një  
                          libri të artë  
Parti e Punës është shkruar në ballë,  
Në mendjen dhe zemrat tonë,  
Përpara...

*Maj 1969.*

## G A Z E T A R . .

Gjithnjë jemi në lëvizje, udhëtim,  
I biem vendit nga jugu në veri,  
Në bllokun e shënimeve e futim tërë atdheun:  
Uzinat, tokën, njeriun e ri...  
Ecim nëpër tokën tonë, agim më agim  
Dielli na buzëqesh që andej nga lart,  
Në zemër na rreh tiktaku i shpejtë i punës,  
Pulsi i atdheut, popullit, revolucionit...

*Maj 1969*

## TAKIMI I BABËS ME DJALIN KUFITAR

Dredhin këmbëkryq në park nga një duhan.  
Ai i tregon për jetën në kufi...  
Plaku i ka ndezur mendimet e punës në  
kooperativë...

Dëgjon djali babën tek flet për ugaret dhe arat,  
Për nënë dhe vajzën...

Nxiton për në postë.  
Ati mbetet vetëm, veç shumë i gëzuar...

U ndanë. Tanj nuk dredhin më bashkë duhan  
Por një mendim, një ide kanë të përbashkët...  
Toka dhe mbrojtja...

*Maj 1969*

## **FRYMËZIMET E PARA**

**D. B.**

Mes linjash telefonike, ku rendin fraza të  
pastra,

Fjalë dashurie, orientimet, lajmet...

Shoh një quell të kaltër.

Ti këndon një këngë partizane,

Ecim anës trasesë, në buzë të xhades...

Më thuaj, e dashur, c'është kjo që më trazon?

Mos vallë këto grunaja...

Vullnetarët me çiltërsinë e tyre rinore?

Ndoshta këta kooperativistë dhe autokombajna,

Që korrin nën hijen e kullave të tensionit,

Në një sfond të qeshur të natyrës shqiptare?

M'i kuption, ti, vajza ime, vargjet e shkruara  
në rrugë?..

Po të tjerët do të m'i kuptojnë  
Frymëzimet e mia të para?...

*Korrik 1969*

## KJO RRUGË...

Është më e shtrenjta rrugë...  
Këtu hodha çapet e parë të fëminisë.  
Si një lule që çel, çela pranë kësaj rruge të mirë.  
Dhe renda sa herë këmbëzbathur mbi gurët.  
Muret i vështroja që sipër si pilot,  
Pemët më mbajtën në krahët e tyre,  
Përplasa topin në dritaret fqinje,  
U rrëzova, u ngrita...

Ajo tani është shtruar me asfalt,  
Veç s'mund të m'i zhdukë kujtimet fëminore,  
Ndrisin neonet natën, mbrëmjeve  
Plepat flladiten në djepin e erës.  
E vështroj rrugën time dikur të vogël,  
Sa nuk na nxinte,  
Po ajo rrugë, po ajo gjerësi

Po më e hapur më duket, më e ngrrohtë. Eh,  
vitet,  
Mbi të breza të tjerë do të hedhin hapat; ja,  
luajnë,  
Rriten . . .

*Korrik 1969*

## **BAZA PARTIZANE**

Është një shtëpi qerpiçi në rrugicë,  
Nr. 48.

Çelen kanatet. Eci drejt zemrës së saj,  
Si ecnin ilegalët dikur...

Ngre një rrobe, palos një tjetër  
Rrobe partizane...  
Eh, të bukurat veshje dhe yll' i kuq  
Më hedhin në vitet e maleve...

Këtu tek jam u ulën dhe ata,  
Sa biseda bënë orë e pa orë,  
Sa halle të popullit shpleksen në biseda,  
Mbështetur në tytën e pushkës së ngrohtë...

Në rrugicë luajnë fëmijët,  
Dy kalimtarë nxitojnë mbi kalldrëm,  
Jeta lëviz. Ngjitje...  
Drejt epokës së kuqe,  
Që hapën këto vatra të kuqe...

*Korrik 1969*

## KËNGA LABE...

Rri ndenjur dhe një kafe pi,  
Qëndron përballë një plak i moshuar,  
Megafoni përçollë lajmin e një këngë,  
U afrua...

Qëndroi pranë radios  
Si të qëndronte pranë këngës,  
I ndryshon fytyra si notat, si zëri  
Tek rri i mbështetur ballë pasqyrash;  
Në shpirtin e këngës është futur i teri...

Kënga labe, e fortë, heroike  
Rrëshqet kudo dhe vendos qetësi.  
E dëgjojnë tani të gjithë këngën e trimave;  
Vështrojnë këtë plak, që humbi pas saj si  
                          baba pas fëmijës...  
Është mëngjez, ka lëvizje...

*Korrik 1969*

## BOTA E NJË PUNËTORI

Futem tek ata pa vështirësi të madhe,  
Eshtë një botë e hapur, e gjerë, e pastër...  
Një botë që rrökullis errësirën honeve të  
shekujve që shkuani...

Punëtori nuk ka shumë fjalë si një ciceron  
në muze,  
Por ka bula djerse në ballin pa rrudha,  
Një histori proletare të thurur me heroizëm,  
Ka një parti...  
E me të na prin ndër ditët e revolucionit...

*Korrik 1969*

DY VAJZA FSHATARE

Nga gropa nxirrnin pleh me cfurkun e gjatë,  
Fushës së pamatë binte mbrëmja,  
Yjet nxirrnin kokën lart atje në qiell,  
Shkumbini i shterrur shkiste ëndërrtar,  
Të dyja vajzat më thirrën pranë. . :

Korrik 1969

## P E I S A Z H

Lëmshi i diellit zbertheu trungjet, gjethet  
E ra në tokë.  
Banorët shkundën plogështinë e natës e rrëmbyen  
shatin...  
Malet kalorës veshën kostumin e gjelbër të ditës,  
Jeta rifilloi tej fshatit....

Si një kurorë natyra e ka vënë në kokë të maleve  
Këtë pyll të atdheut tim.  
Pemët qindravjeçare zgjaten në qiell dhe në tokë,  
Aroma e drurëve përzihet me ajrin e pastër...  
Midis asaj bote cicërimash, flladi e zhurme  
sharrash,  
Jeta levrin me tërë gjallërinë e saj...  
Mushkëritë i zbraza nga pluhurat e rrugëve,  
Eci nëpër monopatet e fshatit për tek  
sharraxhinjtë

Dhe më shplodhen pulpet,  
Një ndjenjë e ëmbël për vendin tim më ngroh... .

Korrik 1969

**MAKSI!...**

## Dolores

Më thirri, apo ndoshta m'u bë?..  
Iku. E pashë midis parkut  
Si midis një ekrani...  
Ktheu kokën prapa e me dorë më përshëndeti...

Gusht 1969

## DITËN E MBARË! DITËN E MIRË!..

Mbrëmja... Perëndoi...  
Tri sirena ndahen në hapësirë,  
Udhëtoj...  
Sa jetë e gjallë! Lëvizje...  
Qindra e mijëra mbushin këtë jetë,  
Këta damarë të atdheut tim...  
Shkojnë në punë...  
Kthehen...  
Mbi bicikleta ngasin në të dy drejtimet,  
Dhe s'lodhen...  
Dhe s'jepen...  
Për lumturinë e të gjithëve...

Mëngjezi... Agoi...  
Tri sirena ndahen në hapësirë,  
Shkojnë...  
Kthehen...  
Ditën e mbarë! Ditën e mirë!..

## NJË FËMIJË NË AUTOBUZ

Më qeshte kaq ëmbël pa më njojur fare,  
(Sa të çiltër janë fëmijët!)  
Dy duar mbështeste mbi gjunjët e nënës,  
Babai, e përkëdhel...

Si një glob kthente kokën majtas edhe djathtas  
Fëmija nga fshati,  
I vështronte të gjithë,  
Të gjithëve buzëqeshje u fali...

Si grup mozaikësh më ngjante, gëzimi i tij,  
Sa i vogël qe ai...  
Erdhi stacioni... Zbriti...  
Prapa shikoi. Buzëqeshi. Lamtumirë...  
Më la një të madhe dashuri...

*Shtator 1969*

## H A P A...

Hapa në shkallët e muzeut...  
Në mur një tabllo.<sup>1)</sup> Seç ndjej!...  
Hapa në rrugë dhe në mendimin tim...  
Ti kë sheh? Kë përgjon? Është natë. Ç'orë?  
Ndërsa shoku traktet nëpër mure ngjit.

Rroftë Partia!...  
Këmbëzbathur e fytyrëhequr të dy  
Shpinat si gjokset i keni pranë e pranë,  
U ngjit...  
Në ç'drejtim atë mbrëmje dimri ikën?..

Poçi me qirish dhe furça mbështetur në tokë,  
Trakti mbështetur në kraharor të popullit.  
Mblidhen të gjithë, lexojnë...  
Kush i ngjiti? Kur?..

Hapa t  r nd  mbi rrug n me kalldr m...  
Eg rsia nxiton te at  nat  t ju vriste...

Hapa t  leht  mbi qylymin n  shkall t  
e muzeut.

Vij drejt jush...  
Shoh figur n tuaj, momentin tuaj  
Dhe ju k rkoj  
Ju, bij t  popullit,  
Ku t ju k rkoj?  
Ku jeni sot ju?...

*Tetor 1969*

---

1) Tabillo n  hyrje t  muzeut t  Beratit.

## **MBAS MESIT TË NATËS**

*D. B.*

U largova nga hoteli,  
S'më mbante dhoma,  
Dola rrugëve të qytetit këto orë të vona..

Drita, drita, drita,  
Freski e lumit, e motit.  
Vjeshtë e vonë largohet tutje, tutje,  
Si zog shtegëtar largohet...

Me flokët hedhur supeve,  
Me sy të zez që shpojnë si shigjetë,  
Kur ecja rrugës në shetitore më shfaqeshe,  
E dashura ime, e qeshur...

Mbas mesit të natës,  
Diku në një tryezë rrumbullake,

Ulur në një kolltuk muzeu  
Shënova këto vargje...

Qe vonë, qe ftohët,  
**Por nxehjtë kisha...**  
Ti më rrije pranë...

*Tetor 1969*

KUR TË MË DHUROSH NJË DITË NJË FËMIJË...

P<sub>A</sub>, B<sub>A</sub>

E dashur, do të më dhurosh një ditë një fëmijë. . .  
Të shëndetshëm dhe të qeshur, e di.  
Si ai fëmija në duart e babës, që ecën  
Në trouarin karshi, . . .

Ç'ëndërr po sheh, ç'ëndërr, o fëmi?  
Ndërsa ati yt të nanurit me një zë melodioz  
«Ke marrë pushkën ke dalë pér liri vatan. . .»  
Është natë, qetësi,  
Nuk ka shumë lëvizje si në sheshin e madh të  
Tiranës.

Ku ishit kaq vonë? ..

Tetor 1969

### **NGA THELLÉSI E TOKËS...**

Si bajoneta pushke sipër dalin lapidarët,  
Nga thellësi e tokës ku flenë heronjtë  
Në radhë, shumë të rregullta, radhë...

Dhe shkruajmë për ta një ditë poezi,  
Një këngë, jo vaj as dhe elegji,  
Por këngë që malet në fusha i gdhin,  
Në barrikada rrugët, sheshet.

Në këto male e barrikada  
Kanë zënë vend si pjesëza të tyre,  
Edhe në këtë zyrë redaksie janë ata,  
Nëpër rreshta shkrimesh ballëlartë  
Si në një mëngjez dielli hedh rreze  
Këtu, atje, kudo, skaj më skaj...

Katroret e hartës dhe të trollit mbushur janë,  
Si bajoneta pushke sipër dalin lapidarët,  
Nga thellësi e tokës ku flenë heronjtë  
Në radhë, shumë të rregullta, radhe...

*Nëntor 1969*

## DO TÈ BLEROJÈ...

D<sub>1</sub> B<sub>1</sub>

Ne qemë mbrëmë te rruga e dashurisë,  
Dhe herë të tjera bashkë do të shkojmë aty.  
Në kujtime do të na zbulohen kohët, vitet  
Si pas kores së tokës zbulohen nënështresat...

Ndoshta një ditë këta rrapi sëpata do ti presë,  
Apo do të jenë moshuar e bërë pleq si ne.  
Rrapat do të ndryshojnë, por dashuria e vërtetë  
Do të mbesë. Ti dije, e dashura ime, këtë...

Nëntor 1969

## N E N A T . . .

### Poemë

Vijnë pas pune e ulen në oda të shplodhin  
gjymtirët;

Veç s'u mvrenjtën një herë.  
Buzëgaz bisedojnë për të rejat e ditës,  
Punët e stinës, planet, politikën. . .

Ku nuk ju gjen, o nëna!?  
Si kallëzat e grurit keni mbirë kudo në këtë  
fushë të gjerë,  
Ju, që dje feroxhetë e shamitë e bardha  
I lanit çdo ditë,  
Që t'ju nxinin edhe më shumë ditët tuaja  
mbushur me andralla. . .

Mos mendoni se heshtja e tyre do të ngjitej  
me heshtjen

Si lule-varëset ngjiten trupit të pemëve;

Që të vinte kjo ditë,

Ato ushqyen me qumështin e gjirit të tyre

Atë këngë të fuqishme,

Që doli nga thellësitë e këtij trolli të lashtë,

Dhe ajo këngë do t'u sillte dritën...

Kish vuajtur Shqipëria shekuj pas shekujve  
Nga uria dhe zia.

Por mbi të gjithë-ëndrrat e këputura,

Të paarrira kurrë,

I kishit ju, o nëna,

Që, kokulura nxitonit muzgjeve në kalldrëmet,

Nëpër monopatet,

Duke mbajtur në supe një krahë dru dhe  
shtëmbat e rënda.

Kur vinte dita,

Kur binte mbrëmja,

Një punë, një ferekhe, një dritarë e frengji...

Ju myllte brenda.

Dhe s'e gëzuat rininë, nëna, o nëna!

Se veshët dhe trupin tua copëtuan gjëmimet  
dhe shtëmbat.

Gjëmonte burri,  
Gjëmonte kanuni.  
Gjëmimet ju ndiqnin.  
Ju rrotullohej rinia, freskia  
Përballë magjes,  
Nëpër ara,  
Pranë dyerve të kishave,  
Nën shandanet e shtëpive lluksoze,  
Me gjëmimet e ztgjatura përzihej edhe zëri i  
lindjes së brezit tjetër,  
Ulërimat e goditjet e kohës...

Kur lindja sillte Shkurten,  
sillte dhe gulçimin e hidhur të burrit  
në shtëpi.  
Atëhere njeri s'e merrte malli për lehonën e  
zbetë,  
As për Shkurten që kish lindur  
E do të ikte Shkurteja si mijëra të tjera.  
Mos vallë ky qe gjëzimi i jetës:  
Një barrë, një lindje, një fëmijë?!  
Burrave, që rrokullenin poçet e rakisë duke  
luajtur  
Nën hijen e gështenjave, nën dëllinja  
Dhe varnin pushkën vetëm natën në muret  
e kullave, afër frengjive.

E shtinin prej tyre si prej qiellit,  
Kanuni u linte trimërinë dhe hakmarrjen,  
Kurse zërit të nënave i vinte frerin!...  
Por do të vinte kënga nga thellësitë e viteve,  
Dhe notat do të nisnin udhën.  
Udhën e lirisë...

Në nisje ishin pak,  
Por ishin rreze drite, që çanin nëpër errësirën  
e shekujve,  
Që më vonë do të shpërndaheshin në tërë  
Shqipërinë  
Dhe do të zgjonin mendimin e myllur në  
guackën e kohës për  
lirinë e barazinë.  
Apo jo, Persefoni e ti, Bule heroina?

Viteve dhe cuca të tjera kishin ngritur krye  
si lulet në male;  
Kujtoni Shota Galicën trimreshë!  
Por, si këto lule që mbinë pas 8 Nëntorit,  
Kaq të vyera, komuniste,  
S'kish njohur Shqipëria asnjëherë.  
Këto cuca i përkisnin një epoke tjetër:  
Komunizmit.

Ndaj u çuan së bashku një trup kundër fashizmit.  
Si një fishkëllimë e mbytur kaloi caku i ndarjes,  
mosbarazisë;

Revolucioni nuk pranon mendime të kalbura  
në vijën e tij,  
Në kulmin e zemërimit burra e gra u hodhën  
për liri...

E si mos t'i duam nënët?  
Ato që na ushqyen me gjakun e tyre,  
Na ndërruan të linjtat kaq herë?  
Nënët e dhimbura, fisnike,  
Që rrinë pranë nesh kur na dhemb koka e bën  
nxehthë.  
Nënët bujare që na bënë zemrën dhe kokën,  
Që çdo ditë na urojnë «ju paçim bij të mbarë  
si tokën!...»

Kush thotë se nënët qenkérkan vetëm për të  
vegjëlit?  
Dhe, pasi të ka rritur si pishë të lartë,  
S'të vjen mirë që nëna të të përkëdhelë?  
Kush hodhi rromuze për nënët që përgjokan  
çupat,  
Dashuriçka mos bëjnë?...

Fanatizmi si ulkonjë përgjon veshëngritur,  
Kërkon të mbushë zemrat e tyre me farmak:  
«Çupën tënde e pamë me djalin e tij. . .»  
Obobo, të gjorat nëna ç'heqin atë çast!  
Kush hedh për to rrromuze të rëndomta  
Kur ruajnë fëmijët mos bëjnë dashuriçka?  
Si mos kujdesen ato për fëmijët, që ndër deje  
                                  u shket i njëjti gjak,  
Që u dhanë mish nga mishi i tyre,  
Që i mbajtën nëntë muaj në bark?..

Edhe ato kanë dashuruar në jetë  
Shumë dritë, barazi dhe bukë,  
Shokun e jetës e të punës,  
Partinë e shtrenjtë që u çeli sytë.  
Ndaj nënët tona nuk janë me të vjetrën...

Tashmë shumë janë kërrusur, dhe disa këmbët  
më s'i mbajnë,  
Vajzat u bënë nëna,  
Nënati po bëhen gjyshe,  
Gjyshet na jatin përshëndetjet e fundit...  
Në kokë u zbardhin thinjat e bardha,  
Thinjat që kanë mbledhur gjithë hallet e mundin  
  
Hallet e mundin...  
Po sa halle u nxori atyre kanuni

Që, edhe pse kish pësuar kontuzion në kollonë  
vertebrale  
Për të tërë këta vite të lirisë, akoma mbahej!

Si zbërthehen lëvozhgat e pemëve në dimirin e  
acartë,

Në te zbërtheheshin nën akull të ftohtë  
Paragrafe mesjetarë,

Që, si gjymtyrët e një të vdekuri, qenë lidhur  
në kapituj barbarë.

Doje një lopë, fut dorën në xhep e më jep  
paratë;

Doje një grua, rras dorën në kanun e më sill  
një pajë.

Kafshët dhe gruaja,

Qenë mpleksur si fijet e leshit në çorape.

Trashëgoi Shqipëria ligje e paragrafe të zez.

Veç, si ky kanun i egër, që aq i egër binte  
përmbi nënët,

Nuk patën lindur kurrë këto kulla të ftohta, të  
largëta...

Do të rrjedhin vite të tjerë, vite të ndritur,  
Por si një mëngjez pérherë 6 Shkurti do të  
zbardhë;

6 Shkurti 1967, së fundi,  
Shkurtet nga kanuni dhe perënditë i ka ndarë...

I duam nënët,  
Që na bënë kokën, zemrën,  
Se në gjoksin e tyre futëm kokën tonë.  
Nëna, që na përkëdhelin mbrëmjeve,  
Na këshillojnë,  
Na marrin erën e djersës, kur kthehem i nga puna.

Kur thotë njëri «gëzuar ditën e lindjes, u bëre  
kaq e kaq vjet»,  
S'na vjen mirë të na kujtojnë se rritemi në moshë.  
Ikin vitet, ikën një vit e vjen një tjetër,  
Koha s'ndalet, vrapon...  
Eh, sa do të donim pranë nesh të qëndronit, nëna  
Të dashura, të urta gjithmonë!  
Që, një frazë, një fjalë, një këshillë  
Të na jepnit rrugës kur kalojmë.  
Nëna të shtrénja, që mbi supe vitet u rëndoijnë...

Ju kanë rënduar këto vite shumë,  
Ndaj thinjat në kokë i keni radhë.  
Në një kohë kur s'duhej t'ju mbinte asnë  
thinjë mbi ballë...

Por i duam thinjat tuaja, sepse janë tuaçat,  
I duam thinjat tuaja, sepse janë dhe tonat.  
Dhe ndofta ndonjë thinjë u shfaq në kokat e  
bukura

Kur na pritnit tē ktheheshim nga puna  
mbrëmjeve vonë.

Mos u mërzonni tani, kur si statuja rrimë  
pérpara jush

Tek na pyesni se ku ishim mbrëmë pas punës.

Me pyetje bomba,

Me pyetje dush.

Kuptoni, erdhi koha

E diku do t'i hedhim sytë pér tē gjetur shokun  
e jetës,

Pér tē zbërthyer ndjenjat e pastra tē dashurisë

Që kemi në zemër

U thinjët, nënënat tonë, u thinjët...

U rritëm, nënënat tonë, u rritëm...

Nuk jemi më fëmijë si atëherë,

Kur endeshim ndër rrugica tē shurdhëra, pa  
dalje,

Këmbëzbathur luanim me top, sa ktheheshim  
nga shkolla...

E mbajmë mend kur na dhatë edhe ndonjë  
shuplakë

E ju dhimbte zemra, ndërsa ne qanim nga zori.

Kur kalonim pranë gështenjëpjekësve,

(Tani ata janë zhdukur si lulet e thata)

I hiqnim këmbët zvarrë si të paralizuar,  
Dönim gështenja ne çamarrokët  
Që lindëm nën gjëmime pushkësh  
Dhe as mendonim  
Se ju rëndoheshim me kërkesa pa fund:  
«Blemë karamele, kallama, hallvasie...»

Eh, ku e dinim se, ndoshta, çanta zbrazur ish,  
E keq ju vinte që s'na plotësonit dëshirën!  
Kishim kërkessa të shumta, me listë  
Si fëmijë të vegjël, pa ojna, pa hile. . .

Diku u kacavjerrëm nëpër mure e pisha,  
E nuk trembeshim tek futeshim thellë në det.  
Nga bregu na thërrisnit:  
«Jo larg, jo larg, mos mbyteni, kujdes! . .».

Tani filluat të kërruseni, dhe zemrat disa më  
si mbajnë,  
Në supe mbani tërë rrugët e frontit dhe të punës  
Por, si nuk kërkuat njëherë prehje, qetësi?  
Nëna të bukura, plot hijeshi!..  
Sikur në horizont të dukeshin hijet e armikut,  
Si në luftën e madhe do të rreshtoheshit  
përsëri krah për krah,  
Nëna luftëtare, ushtare...  
Nëna të ditëve të reja komuniste!..

Prill-Maj 1969

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Mendimi i tij .....	3
8 Nëntor 1971 .....	5
Rrezet rendën .....	7
Me natën .....	9
Dashuria .....	10
Takim me babanë e dëshmorit Mark Rrëza .....	11
Tani u bëmë burra .....	12
E kuqe, e kuqe .....	14
Në Vlorë .....	15
Vrella .....	17
Komisarët .....	19
Kudo .....	21
Gazetar .....	22
Takimi i babës me djalin kufitar .....	23
Frymëzimet e para .....	24
Kjo rrugë .....	26
Baza partizane .....	28
Kënga labe .....	30
Bota e një punëtori .....	31
Dy vajza fshatare .....	32
Peisazh .....	33
Maksi! .....	34
Ditën e mbarë! Ditën e mirë! .....	35
Një fëmijë në autobus .....	36
Hapa .....	37
Mbas mesit të natës .....	39
Kur të më dhurosh një ditë një fëmijë .....	41
Nga thellësi e tokës .....	42
Do të blerojë .....	44
Nënët .....	45